

APIS 200 SE

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



“KUJDES”

Lexo fleteudhezesin para perdorimit

APIS 200 SE eshte insekticid me veprim kontakti dhe stomaku, i cili ka për qëllim kontrollimin e insekteve që thithin dhe kafshojnë. Produkti ka efekt kontakti, translaminar dhe sistemik te bimët.

Në përputhje me klasifikimin IRAC, substanca aktive, acetamiprid, klasifikohet si grupi 4A.

Përmbajtja: *Acetamiprid 200 g/l (18,8%)*

Formulimi: *Emulsion i suspendushem (SE)*

Masat parambrojtese:

- Mbajeni në vënde të sigurta dhe të pa arritëshme nga fëmijët.
- Evitoni kontakte të zgjatura të syve dhe lëkures me preparatin.
- Evitoni marrje të preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit spërkates dhe gjatë spërkates.
- Gjatë perdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe tymos duhan.
- P264 Lani duart, parakrahët dhe fytyrën plotësisht pas perdorimit
- P201 Merrni udhëzime të veçanta para se ta përdorni.
- P280 Vishni doreza, veshje mbrojtëse, mbrojtëse për sytë, fytyrë.
- P391 Mblidheni atë që derdhet.
- P308+P313 Në rast ekspozimi ose kontakti: Kërkoni ndihmë/kuj des mj ekësor.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H302: I demshem nese gellititet. Ne rast gellititje, marje me organet e frymamarjes dhe me lekuren shkakton keto shenja: iritim te syve, spazme muskulare, dispnea, cionoze, ataksi te mundeshem, bradikardi.
- H410 Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata.
- H361d Dysshohet për dëmtim të fertilitetit ose fëmijës së palindur
- Në rast kontakti me lëkuren ose mukozat lahuni me uje të bollëshem dhe sapun.
- Në rast thithje të tretësires spërkatese me organet e frymëmarrjes i aksidentuari vendoset në një mjedis të ngrohtë dhe të ajrosur.
- Ne rast helmimi kerkoni menjëherë ndihmë në qëndrën më të afërt spitalore, duke i treguar mjekut etiketën e këtij produkti. Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi sipas simptomave
- Antidot: asnjë, trajtohet në mënyrë simptomatike.
- Nëse nevojitet këshillë mjekësore, keni në dorë enën ose etiketën e produktit.
- Nëse gellititet: Thirrni një qendër helmi ose mjek nëse nuk ndiheni mirë. Shpëlaje gojën.

Perdorimi:

Patate: kunder bubrecit (*Leptinotarsa decemlineata*). Doza e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,1-15 lit/ha, te tretur ne 200-300 lit uje. Trajtimi duhet të kryhet në momentin e konstatimit të vezëve dhe çeljes në masë të larvave, nga faza 50% e mbulimit të rrjeshtave deri në fazën e lulëzimit të plotë (50% e luleve në lulëzimin e parë janë të hapura) (BBCH 35-65). Përdorni dozat më të larta të rekomanduara në rast të shfaqjes së tyre masive. Aplikohet 1 trajtim/sezon.

Mollë dhe dardhe: kunder afideve (*Aphis spp., Dysaphis plantaginea*). Doza maksimale e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,125 lit/ha, te tretur ne 700-750 lit uje. Aplikoni masën kur shfaqen kolonitë e para të afideve. Kryeni trajtimin nga fundi i fazës së lulëzimit deri në fillimin e lidhjes së frutave, kur frutat të arrijnë madhësinë 10 mm (BBCH 69-71).

Kunder krimbit (*Cydia pomonella*). Doza maksimale e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,2 lit/ha, te tretur ne 700-750 lit uje. Trajtoni në fillim të fluturimit të dëmtuesit dhe të lëshimit masiv të vezëve, në fund të fazës së

lulëzimit, deri në fazën kur diametri i frutave arrin 40 mm, fruti rritet (BBCH 69-74).

Aplikohen 1-2 trajtime/sezon, me interval 30 ditë.

Qersh, vishnje: kunder mizes (*Rhagoletis cerasi*) aplikojeni produktin kur mizat shfaqen shumë herë dhe kur bëjnë vezë në numër të madh. Kryeni trajtimin që nga momenti kur fruti arrin 90% të madhësisë së tij tipike deri në fillimin e pjekjes dhe ngjyrosjes së frutave (BBCH 79- 81). Kunder afideve (*Aphis spp.*) aplikoni masën kur shfaqen kolonitë e para të afideve. Kryeni trajtimin që nga momenti kur fruti arrin 90% të madhësisë së tij tipike deri në fillimin e pjekjes dhe ngjyrosjes së frutave (BBCH 79-81).

Doza maksimale e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,125 lit/ha, te tretur ne 750 lit uje. Aplikohet 1 trajtim/sezon.

Arre dhe lajthi: kunder afideve (*Aphis spp.*), aplikojeni produktin nga fundi i fazës së lulëzimit (BBCH≥69). Doza maksimale e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,2 lit/ha, te tretur ne 200-750 lit uje. Aplikohen 1-2 trajtime/sezon, me interval 30 ditë.

Kolzë vajore dimërore dhe pranverore: kunder *Meligethes aeneus*, *Ceutorhynchus assimilis*, *Ceutorhynchus quadridens*, *Dasineura brassicae*, *Meligethes aeneus*, *Athalia colibri*, *Aphis spp.* Aplikohet në momentin e infektimit nga dëmtuesit në plantacion, sipas sinjalizimit, nga faza kompakte e tufës luleve (gonxhe të dukshme të vetme, të mbyllura në lulëzimin kryesor) deri në fazën e plotë të lulëzimit të kolzës (BBCH 55- 65). Doza më e lartë e rekomanduar duhet të përdoret në rast të një sulmi intensiv të dëmtuesit në plantacion.

Kunder *Ceutorhynchus assimilis*, *Dasineura brassicae* aplikohet gjatë fazës së lulëzimit, nga momenti kur 20% e luleve janë hapur, deri në fund të fazës së lulëzimit (BBCH 62-69). Doza më e lartë e rekomanduar duhet të përdoret në rast të një sulmi intensiv të dëmtuesit në plantacion.

Doza e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,12-0,25 lit/ha, te tretur ne 200-300 lit uje. Aplikohet 1 trajtim/sezon.

Kumbull: kunder *Aphis spp.*, *Hoplocampa spp.*, *Cydia pomonella*, *Parthenolecanium corni*, trajtoni nga fundi i lulëzimit deri në pjekurinë e frutave (BBCH 69-89). Doza e rekomanduar për përdorim të vetëm 0,125-0,2 lit/ha, te tretur ne 600-1000 lit uje. Aplikohen 1-2 trajtime/sezon, me interval 30 ditë.

Domate (serrë), spec (serrë), patëllxhan (serrë): kunder *Trialeurodes vaporariorum*, *Thrips tabaci*, *Frankliniella occidentalis*, *Phytomyza spp.*, *Aphis spp.*, *Lygus spp.*, *Alticini spp.*, trajtoni nga faza e parë e gjethes deri në ngjyrën e plotë të frutave (BBCH 11-89). Doza e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,24-0,3 lit/ha, te tretur ne 600-750 lit uje, për përdorim të dyfishtë 0,12-0,2 lit/ha, te tretur ne 300-500 lit uje.

Fidanishte bimësh dekorative dhe fidanishte pyjore, bimë dekorative: kunder *Aphis spp.*, *Collembola*, *Coleophora laricella*, përdorni agjentin siç tregohet, nga faza e shpalosjes së gjethes së parë deri në fund të lulëzimit (BBCH 11-69). Doza maksimale e rekomanduar për një përdorim të vetëm 0,2 lit/ha, te tretur ne 250-400 lit uje. Aplikohen 1-2 trajtime/sezon, me interval 30 ditë.

Panxhar sheqeri, panxhar foragjer, panxhar i kuq: kunder *Bothynoderes punctiventris*, *Chaetocnema concinna*, *atomaria linearis* dhe *morrat e bimëve*, aplikojeni produktin në faza nga gjethja e dytë deri te gjethja e nëntë (BBCH 12–19). Doza maksimale/e rekomanduar e produktit për një aplikim të vetëm 0.25 l/ha, te tretur ne 300-400 lit uje. Aplikohet 1 trajtim/sezon.

Selino: kunder *vemjeve të pieris brassicae*, *pieris rapae*, *autographa gamma*, *plutella xylostella*, *mamestra brassicae* dhe *vemjet e tjera që ushqehen me gjethë*, *euleia heraclei*, *chamaepsila rosae*, *lygus*, *spodoptera exigua*, *spodoptera littoralis* dhe *morrave te bimëve*, aplikojeni nga gjethja e dytë deri te gjethja e nëntë (BBCH 12-19). Doza maksimale/e rekomanduar e produktit për një aplikim të vetëm 0.25 lit/ha, te tretur ne 300-400 lit uje.

Nespul dhe ftua: kunder *morrave te bimëve*, përdoreni nga fundi i lulëzimit derisa fruta të arrijë diametrin 40 mm (BBCH 69–74). Doza maksimale/e rekomanduar e produktit për një aplikim të vetëm 0.2 lit/ha, te tretur ne 750 lit uje.

Produkti përmban substancën aktive acetamiprid – një përbërës neonikotinoid (insekticide që reagojnë me receptorët e acetilkolinës nikotinike (Ach) – IRAC grupi 4A). Duhet të ndiqen rekomandimet e mëposhtme për të minimizuar rrezikun e rezistencës së insekteve: produkti duhet të përdoret vetëm në dozat dhe periudhat e rekomanduara, të mos tejkalohej numri i rekomanduar i trajtimeve me produktin gjatë sezonit të rritjes, nëse është e nevojshme të bëhen trajtime të tjera, duhet të përdoret një produkt me përbërës aktiv të një grupi tjetër, me mekanizëm veprimi tjetër.

Përgatitja e solucionit:

Përpara se të filloni përgatitjen e lëngut, përcaktoni me kujdes vëllimin e kërkuar së bashku me sasinë e produktit. Kur mbushni spërkatësin, ndiqni udhëzimet e prodhuesit të spërkatësit. Në mungesë të udhëzimeve, shtoni sasinë e matur të produktit në rezervuarin e spërkatësit të mbushur pjesërisht me ujë (me përzierësin e ndezur). Shpëlajini enët e zbratura tri herë me ujë dhe derdhni ato në rezervuarin e spërkatësit së bashku me solucionin, shtoni ujë në sasinë e kërkuar dhe përziени mirë. Pas derdhjes së produktit në rezervuarin e spërkatësit i cili nuk është i pajisur me

një përzierës hidraulik, përzieni lëngun mekanikisht. Në rast të ndërprerjeve në spërkatje, përzieni tërësisht solucionin në rezervuarin e spërkatësit përpara ri-fillimit të spërkatjes.
Lani pajisjet tërësisht pas punës.

Fitotoksiciteti:

Në dozat dhe bimët e rekomanduara nuk shfaq shenja fitotoksiciteti.

Verejtje per përdorimin:

Produkti nuk duhet të përdoret në tokë bazë në prodhimin e kolzës së dimrit, kolzës së pranverës dhe patates.

Spërkatja te insektet (sidomos insektet thithëse) duhet të bëhet e plotë, duke mbuluar të gjitha pjesët e bimës me lëngun spërkatës. Produkti duhet të përdoret në temperaturë më pak se 20°C. Në temperatura më të larta, trajtimi duhet të bëhet në fund të ditës.

Ndikimi në ekosistem:

EUH401: Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim. EUH208: Përmban 1,2-benzoizotiazolin-3-on. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik. Mos e ndotni ujin me produktin ose paketimin e tij. Mos i lani pajisjet në afërsi të ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen e ujërave nëpërmjet kanaleve kulluese nga fermat dhe rrugët. Shmangni derdhjet në mjedis. Gjatë lulëzimit të kulturave të ndryshme, rekomandohet përdorimi i agjentit jashtë periudhave të aktivitetit të bletëve. Mos e përdorni produktin në tokë alkaline. Respektoni një zonë sigurie të paspërkatur prej të paktën 2-3 m me ndërtesat e banimit/banorët dhe palët e treta gjatë spërkatjes me spërkatëse fushe dhe të paktën 5 m gjatë spërkatjes me spërkatëse pemësh.

Për të mbrojtur organizmat ujorë, është e nevojshme të përcaktohet një zonë sigurie me gjerësi 20 m nga rezervuarët e ujit dhe rrugëkalimet e ujit. Për të mbrojtur bimët e tjera dhe artropodet, respektoni një zonë sigurie të paspërkatur prej 5 m nga toka jobujqësore, ose 1 m nga toka jobujqësore, duke marrë njëkohësisht masa që reduktojnë 90% fluturimin e lëngut spërkatës përmes erës gjatë trajtimit.

Karenca:

Të gjitha intervalet midis aplikimit të fundit të produktit deri në ditën kur bima e kultivuar vilet (periudha e pritjes): patatja 7 ditë; kolza 39 ditë; molla, qershia, vishnja, arra, lajthia, dardha, kumbulla, nespulla, ftoi 14 ditë; domatja, specat dhe patëllxhani ne sera 3 ditë.

Periudha midis aplikimit të produktit dhe ditës në të cilën në zonën e trajtuar me produkt mund të futen njerëz dhe kafshë (periudha e parandalimit) 1 ditë.

Kushtet e ruajtjes:

Mbajeni produktin e mbrojtjes së bimëve në paketimin origjinal, në temperaturë 0°C deri në 30°C.

Nr dhe data e regjistrimit: 784, datë 10.3.2023.

Sasia neto e PMB-së, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri në 100 ml, 250 ml, 500 ml;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Data e prodhimit: _____;

Data e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Tipi i ambalazhit bazë: Shishe HDPE/PA dhe HDPE/PA COEX;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Innvigo Sp. z o.o. **Adresa:** Al. Jerozolimskie 178, Warszawa, Poloni. Fabrikuesi: Pentagon-Trade Spółka z ograniczoną odpowiedzialnością Sp.k. **Adresa:** Warszawa, Poloni.

Emri dhe adresa e kërkuesit: Innvigo Sp. z o.o. **Adresa:** Al. Jerozolimskie 178, Warszawa, Poloni.